



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

KËSHILLI BASHKIAK

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)



VENDIM

Nr 66 .datë 28.10 .2022

PËR:

**“ Miratimin e Rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Vau Dejës”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 dt.17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 18, neni 54 (Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak) germa k, dhe neni 55 pika 3, Këshilli Bashkiak Vau Dejës:

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores **“Për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Vau Dejës”** sipas tekstit të rregullores bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015”Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.
3. U shpall sot me date 02.11 .2022



Kryetari Këshillit

Mark BISHA

Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim -




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr.735/1prot.

Shkodër, më 11.11.2022



**LËNDA: Mbi vendimin Nr.66 datë 28.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

**KESHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, neni 56 i KPAD, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, dokumentacionin shoqërues të mbledhjes së Këshillit Bashkia Vau-Dejës të datës 28.10.2022, dërguar nga Sekretari i Këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.6175.prot datë 2.11.2022, Analizoi **VKB Vau-Dejës nr.66 datë 28.10.2022** “Për miratim rregullorje për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashkinë Vau-Dejës”.

Për sa trajtuar, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, në nenin 54/k, neni 55/2, 68 e në vijim, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**

